



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M K.P.P. 384/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.06.2019 shqyrtoi ankesat përkatësisht me:

Objekt:

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Sark” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-05915-01-31-2019, me objekt “*Rikonstrukcion i Rrugëve dhe Qendrës në fshatin Bilçë, Njësia Velabisht, Bashkia Berat*”, me fond limit 12.447.248 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 11.03.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Berat.

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Fled” sh.p.k., në procedurën e mësipërme të prokurimit.”

Shtim i arsyeve të skualifikimit për operatorët ekonomikë “Spektri” sh.p.k. dhe “Sireta 2F” sh.p.k., pjesëmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

“Kevin Konstrukcion” sh.p.k.
Rruga “Adem Jashari”, Nd.4, H.10, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Berat
Rruga “Antipatrea”, Berat

Subjekte të interesuar: “Fled” sh.p.k.
Lagja “Havaleas”, Rruga “Ura e Kozares”, godinë private 1-
katëshe, Nr.307, Kuçovë

“Sark” sh.p.k.
Lagja “8 Shkurti”, Rruga “Skënderbej”, Rajoni nr.3, përballë
supermarket “Lalaj”, Fier

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i
ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.
914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit
publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.
596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për
Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të
ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi
diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori
ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes
në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me
të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i
ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka
paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e
prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e
përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit
të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së
operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 01.02.2019, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-05915-01-31-2019, me objekt “*Rikonstruksion i Rrugëve dhe Qendrës në fshatin Bilçë, Njësia Velabisht, Bashkia Berat*”, me fond limit 12.447.248 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 11.03.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Berat.

II.2. Në datën 11.03.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3 Nga verifikimi në sitemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 28.03.2019 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Spektri” sh.p.k.	7.829.901 lekë, skualifikuar
2. “Fled” sh.p.k.	8.521.341 lekë, kualifikuar
3. “Sark” sh.p.k.	8.813.453 lekë, kualifikuar
4. “Sireta 2F” sh.p.k.	9.247.554 lekë, skualifikuar
5. “Kevin Konstruksion” sh.p.k.	9.334.021 lekë, kualifikuar
6. “K.M.K” sh.p.k.	10.957.230 lekë, kualifikuar
7. “Totila” sh.p.k.	11.611.073 lekë, kualifikuar
8. “Leon Konstruksion” sh.p.k.	11.791.818 lekë, kualifikuar

III.4. Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” sh.p.k. në datën 01.04.2019 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Fled” sh.p.k. dhe “Sark” sh.p.k., në procedurën e mësipërme të prokurimit. Gjithashtu operatori ekonomik ankimues kërkon shtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorët ekonomikë “Spektri” sh.p.k. dhe “Sireta 2F” sh.p.k., me pretendimet si më poshtë vijon:

[...]1.Kundershtojme kualifikimin e ofertes ekonomike te operatori ekonomik "SARK" Shpk duke argumentuar si me poshte:

1. Operatori ekonomik "SARK" Shpk nuk ka paraqitur ne tender vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore, ne te gjitha vendet ku ka ushtruar aktivitet, ne kundërshtim me kriterin kualifikues pika 2.2, ku autoriteti kontraktor ka kerkuar: "Vertetim per shlyerjen e taksave vendore vitin 2017, 2018 sipas vendodhjes se ushtrimit te veprimtarise ne QKR. Operatori ekonomik "SARK" Shpk referuar ekstraktit historik te qendres kombetare te biznesit ka ushtruar aktivitet gjate vitit 2017 dhe 2018 ne keto adresa

a-"Tirane: TIRANE: Tirane:: TIRANE: Str Durrësit, prane Hotel COLOSSEO. Tirane

b-"Fier, FIER: Fier:: FIER: Lagija 8 Shkurti, Rruga Skenderbeji, Fier, Rajoni nr 3 Perball supermarket Lalaj;

c-"Fier: FIER;; Qender Fier; Celigrad, Ish "Parkut te Industrise" rajon nr-3

Operatori ekonomik "SARK" Shpk nuk ka paraqitur vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendor per adresen Tirane, TIRANE, Tirane, TIRANE: Str Durrësit, prane Hotel COLOSSEO. Tirane si dhe per adresen "Fier, FIER; Qender Fier: Celigrad: Ish "Parkut te Industrise" rajon nr-3. Gjithashtu referuar buletin Nr. 12 date 25 Mars 2019 te publikuar prej Agjencise se Prokurimit Publik rezulton se ka detyrime te pashlyera ne Bashkin Fier

2.Operatori ekonomik "SARK" Shpk nuk ka paraqitur ne tender gjithë dokumentacionin e nevojshem ligjor te kerkuar ne dokumentat standarte te tenderit pika 2.3 per mjetet Eskavator me Goma 2 (dy) cope dhe Fadrome 1(nje) cope. Ne lidhje me keto mjete operatori ekonomik "SARK" Shpk nuk ka paraqitur leje qarkullimi, siguracion, kolaudim, etj, megjithese te treja mjetet jane levizese ne rruge dhe si te tilla kerkohet detyrimisht te jene te pajisura me leje qarkullimi.

Operatori ekonomik "SARK" Shpk ne kundërshtim me kriteret kualifikuese pika 2.3 ku Operatori ekonomik duhet te kete certifikatat e meposhtme.

ISO14001: 2015 mbi "Per sistemin e menaxhimit te mjedisit"

SSH EN ISO 9001: 2015 "Mbi sistemet e menaxhimit te cilesise"

OHSAS 18001: 2007 "Shendetin dhe sigurimin ne pune"

ISO 390001: 2012 "Per sistemin e menaxhimit te sigurise ne trafikun rrugor"

ISO 50001: 2011 "Per sistemin e menaxhimit te energjise"

Operatori ekonomik "SARK" Shpk nuk ka paraqitur certifikata te leshuara nga nje organ I akredituar prej Drejtorise se Pergjithshme te Akreditimit ku ti jet dhene e drejta per te leshuar certifikata e mesiperme. Autoriteti kontraktor lehtesisht mund ta vertetoj kete fakt duke i'u referuar faqes zyrtare te DPA <http://dpa.gov.al/sg/organizma-te-akredituara>, ku mund te kontrolloje nese kompania qe ka leshuar certifikatat e mesiperme a eshte e akredituar per te leshuar certifikata te tilla.

4. Operatori ekonomik "SARK" Shpk nuk ka paraqitur vertetim qe ka shyer energjin elektrike per te gjitha kontratat qe ka lidhur me OSHEE sh.a.

5. Operatori ekonomik nuk ka deklaruar ne Deklaraten per Disponueshmerin e Mjeteve te gjitha mjetet e kerkuara ne DST.

Per sa mesiper oferta ekonomike e shoqerise "SARK" Shpk duhet s'kualifikuar.

11.2 Kundërshtojme kualifikimin e ofertes ekonomike te operatori ekonomik "FLED Sh.p.k duke argumentuar si me poshte:

1.Operatori ekonomik"FLED" Shpk nuk ka paraqitur ne tender vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendor ne te gjitha vendt ku ka ushtruar aktivitet ne kundërshtim me kriterin kualifikues pika 2.2, ku autoriteti kontraktor ka kerkuar:"Vertetim per shlyerjen e taksave vendor vitin 2017, 2018 sipas vendodhjes se ushtrimit te veprimtarise ne QKR.

Operatori ekonomik "FLED" Shpk nuk ka paraqitur vertetim shlyerje taksave vendore per Bashkine Berat dhe Bashkin Kucove

Operatori ekonomik "FLED" Sh-pk nuk ka paraqitur dokumentacionin e nevojshem ligjor te kerkuar ne dokumentat standarte te tenderit pika 2.3 per mjetet Eskavator me Goma 2(dy) cope dhe Fadrome 1(nje) cope. Ne lidhje me keto mjete operatori ekonomik "FLED" Shpk nuk ka paraqitur leje qarkullimi, siguracion, kolaudim, etj megjithese te treja mjetet jane levizese ne rruge dhe si te tilla kerkohet detyrimisht te jene te pajisura me leje qarkullimi.

3. Operatori ekonomik"FLED" Shpk ne kundërshtim me kriteret kualifikuese pika 2.3 ku jane kerkuar: Operatori ekonomik duhet te kete certifikatat e meposhtme:

ISO14001: 2015 mbi "Per sistemin e menaxhimit te mjedisit"

SSH EN ISO 9001: 2015 "Mbi sistemet e menaxhimit te cilesise"

OHSAS 18001: 2007 "Shendetin dhe sigurimin ne pune"

ISO 390001: 2012 "Per sistemin e menaxhimit te sigurise ne trafikun rrugor"

ISO 50001: 2011 "Per sistemin e menaxhimit te energise"

Operatori ekonomik "Fled" Shpk nuk ka paraqitur certifikata te leshuara nga nje organ i akredituar prej Drejtorise se Pergjithshme te Akreditimit ku ti jet dhene e drejta per te leshuar certifikata e mesiperme. Autoriteti kontraktor lehtesisht mund ta vertetoj kete fakt duke i'u referuar faqes zyrtare te DPA <http://dpa.gov.al/sq/organizma-te-akredituara>, ku mund te kontrolloje nese kompania qe ka leshuar certifikatat e mesiperme a eshte e akredituar per te leshuar certifikata te tilla.

4. Operatori ekonomik "FLED" Shp k nuk ka paraqitur vertetim qe ka shlyer energjin elektrike per te gjitha kontratat qe ka lidhur me OSHEE sha

5. Operatori ekonomik nuk ka deklaruar ne Deklaraten per Disponueshmerin e Mjeteve te gjitha mjetet e kerkuara ne DST. Per sa mesiper oferta ekonomike e shogerise "FLED" Shpk duhet s'kualifikuar.

11.3 Kerkojme shtimin e arsyeve te s'kualifikimit per operatoret ekonomik ekonomik "SPEKTRI" Shpk dhe "SIRETA2F" Sh.p.k si me poshte:

1. Operatore ekonomik "SPEKTRI" Shpk dhe "SIRETA 2F" Shpk nuk ka paraqitur në tender gjithë dokumentacionin e nevojshem ligjor te kerkuar ne dokumentat standarte te tenderit pika 2.3 per mjetet Eskavator me Goma 2(dy) cope dhe Fadrome 1 (nje) cope.

Ne lidhje me keto mjete operatore ekonomik "SPEKTRI" Sh p k dhe "SIRETA 2F" Shpk nuk kane paraqitur leje qarkullimi, siguracion, kolaudim, etj megjithese te treja mjetet jane levizese ne rruge dhe si te tilla kerkohet detyrimisht te jene te pajisura me leje qarkullimi.

3. Operatoret ekonomik "SPEKTRI" Shpk dhe "SIRETA 2F" Shpk ne kundersiztim me kriteret kualifikuese pika 2.3 ku jane kerkuar: "Operatori ekonomik duhe te kete certifikatat e meposhtme: ISO14001: 2015 mbi "Per sistemin e menaxhimit te mjedisit"

SSH EN ISO 9001: 2015 "Mbi sistemet e menaxhimit te cilesise"

OHSAS 18001: 2007 "Shendetin dhe sigurimin ne pune"

ISO 390001: 2012 "Per sistemin e menaxhimit te sigurise ne trafikun rrugor"

ISO 50001: 2011 "Per sistemin e menaxhimit te energise"

Operatori ekonomik "SPEKTRI" Shpk dhe operatori ekonomik "SIRETA 2F" Shpk nuk kane paraqitur certifikata te leshuara nga nje organ i akredituar prej Drejtorise se Pergjithshme te Akreditimit ku ti jete dhene e drejta per te leshuar certifikatat e mesiperme. Autoriteti kontraktor lehtesisht mund ta vertetoj kete fakt duke i'u referuar faqes zyrtare te DPA <http://dpa.gov.al/sq/organizma-te-akredituara>, ku mund te kontrolloje nese kompania qe ka leshuar certifikatat e mesiperme a eshte e akredituar per te leshuar certifikata te tilla.

Per sa mesiper kerkojme shimin e arsyeve te s'kualifikimit per operatoret ekonomik "SPEKTRI" Shpk dhe "SIRETA 2F" Shpk.

II.5. Referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor si dhe dokumentacionit bashkëngjitur ankesës së operatorit ekonomik ankimes, autoriteti kontraktor në datën 08.04.2019, me anë të shkresës nr.1759/1 prot., i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimes duke e refuzuar atë. Operatori ekonomik ankimes pretendon se ka marrë dijeni në lidhje me

kthimin e përgjigjes në datë 10.04.2019. Konkretisht, autoriteti kontraktor, në kthimin e përgjigjes ka sqaruar:

“[...] Referuar ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” I ndryshuar, neni 21, “E drejta e informimit”. Informacioni i administruar, sipas nenit 12 të këtij ligji, I vihet në dispozicion cdo personi të interesuar, palë në process, me kërkesë të tij, pasi ka përfunduar klasifikimi I ofertave. Autoriteti kontraktues është I detyruar ta vërë në dispozicion informacionin brenda 5 ditëve nga data e marrjes së kërkesës. Për sa më sipër, për të vërtetuar nëse dokumentacioni I paraqitur në sistemin elektronik është në përputhje me kriteret e vendosur në dokumentat e tenderit ju duhet të paraqisni pranë Bashkisë Berat një kërkesë për tu njohur me dokumentacionin e ngarkuar në SPE nga operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.

II.6. Në datën 12.04.2019 operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoriteti kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 2115/1 prot., datë 19.04.2019, protokolluar me tonën në datën 25.04.2019, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Kevin Konstruktion” sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik “Sark” sh.p.k. me arsyetimin se *“Operatori ekonomik “SARK” Shpk nuk ka paraqitur ne tender vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore, ne te gjitha vendet ku ka ushtruar aktivitet, ne kundërshtim me kriterin kualifikues pika 2.2, ku autoriteti kontraktor ka kerkuar: “Vertetim per shlyerjen e taksave vendore vitin 2017, 2018 sipas vendodhjes se ushtrimit te veprimtarise ne QKR”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 12 *“Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.2. e “Kapacitetit ekonomik dhe financiar”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri: “Vertetim per shlyerjen e taksave vendore vitin 2017, 2018 sipas vendodhjes se ushtrimit te veprimtarise ne QKR.”*

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Sark” sh.p.k., të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, për të përmbushur kriterin e mësipërm, konstatohet se është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

- Ekstrakt i Regjistrisë Tregëtare të shoqërisë “Sark” sh.p.k., lëshuar nga QKB

- Ekstrakt Historik i Regjistrisë Tregëtarë të shoqërisë “Sark” sh.p.k., lëshuar nga QKB.
- Vërtetim Nr.202 prot., datë 20.04.2018 lëshuar nga Bashkia Fier, me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Sark” sh.p.k. ka shlyer detyrimet vendore ndaj Bashkisë Fier deri në 31.12.2018.
- Vërtetim Nr.212 prot., datë 30.03.2017 lëshuar nga Bashkia Fier, me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Sark” sh.p.k. ka likuiduar detyrimet vendore deri në vitin 2017.
- Vërtetim Nr.35 prot., datë 03.07.2018 lëshuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Mirditë, me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Kthella” sh.p.k. ka likuiduar detyrimet vendore për vitin 2018.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.4. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.5. Referuar sa më sipër, Komisioni konstaton se, në kriterin e vendosur në dokumentat e tenderit, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës një dokument që vërteton se kanë shlyer të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, sipas vendndodhjes së ushtrimit të veprimtarisë së tyre, sipas QKR për vitet 2017 dhe 2018. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Sark” sh.p.k., rezulton se ky i fundit, referuar Ekstraktit të Regjistrisë Tregëtarë, ushtron aktivitet në Republikën e Shqipërisë me Zyrë Qëndrore në Fier, Lagja “8 Shkurti”, Rruga “Skënderbej”, Fier, Rajoni Nr.3, Përballë supermarket Lalaj, si edhe referuar këtij Ekstrakti në pikën 13 *Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit* ushtron aktivitet në Tiranë, Str Durrësit, pranë Hotel Colosseo, Tiranë. Nga shqyrtimi i Ekstraktit Historik të kësaj shoqërie, rezulton se për vitin 2017 dhe 2018, kjo e fundit ka ushtruar aktivitet në Bashkinë Fier dhe Bashkinë Tiranë, konkretisht në datën 27.01.2011 është shtuar adresa “Fier, Qendër Fier, Celigrad, ish “Parkut të Industrisë”, Rajoni nr.3” dhe në datë 25.01.2018 është shtuar adresa “Fier, Lagja “8 Shkurti”, Rruga “Skënderbej”, Fier, Rajoni Nr.3, Përballë supermarket Lalaj” dhe është hequr adresa “Fier, Qendër Fier, Celigrad, ish “Parkut të Industrisë”. Gjithashtu, në datën 21.12.2018 është shtuar adresa “Tiranë, Str Durrësit, pranë Hotel Colosseo, Tiranë”. Pra referuar këtij ekstrakti rezulton se, shoqëria “Sark” sh.p.k. për vitin 2017 ka ushtruar aktivitet në Bashkinë Fier dhe për vitin 2018 ka ushtruar aktivitet në Bashkinë Fier dhe në Bashkinë Tiranë. Operatori ekonomik “Sark” sh.p.k. në përmbushje të kriterit të mësipërm ka dorëzuar vërtetime të lëshuara nga Bashkia Fier, me anë të të cilave vërtetohet se kjo shoqëri nuk ka detyrime

të taksave dhe tarifave vendore të pashlyera në këtë Bashki për vitet 2017, dhe 2018, por ky operator ekonomik nuk ka paraqitur vërtetim se ka shlyer detyrimet për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Tiranë për vitin 2018, për sa kohë që nga Ekstrakti i kësaj shoqërie rezulton se ka kryer aktivitet edhe në Bashkinë Tiranë nga data 21.12.2018 e në vijim.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i ekstraktit historik të shoqërisë “Sark” sh.p.k., të lëshuar nga QKB dhe vërtetimeve të lëshuara nga institucioni vendor i bashkisë ku operatori ekonomik “Sark” sh.p.k. ka ushtruar aktivitet, rezulton se ky i fundit nuk ka vërtetuar se ka shlyer detyrime lidhur me taksat dhe tarifat vendore për vitet 2018, në të gjitha vendet ku ka ushtruar aktivitetin e tij tregtar, konkretisht për Bashkinë Tiranë.

KPP arsyeton se, duke qenë se sipas legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar, në përputhje me ligjin që rregullon regjistrimin e biznesit, të kryejë regjistrimet në regjistrin tregtar, të kryejë regjistrimin e subjekteve të përcaktuara në ligjin që rregullon regjistrimin e biznesit, për qëllim të regjistrimit fiskal, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe të inspektimit të marrëdhënieve të punës, të lëshojë certifikata, ekstrakte të regjistrimeve dhe kopje të vërtetuara të akteve të depozituara, të publikojë të dhënat e regjistruara, sipas ligjit që rregullon regjistrimin e biznesit, si dhe siguron aksesin e lirë të publikut në to, atëherë edhe verifikimi i vendeve ku shoqëria “Sark” sh.p.k. ka kryer aktivitetin e saj gjatë vitit 2018 do të bëhet referuar ekstraktit të publikuar nga QKB për këtë shoqëri.

Sa më sipër, Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Sark” sh.p.k., nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar lidhur me shlyerjen e detyrimeve vendore ndaj vendeve ku ka ushtruar aktivitet për vitin 2018, duke mos plotësuar kështu kërkesën e vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” sh.p.k. për kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “Sark” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që i është pranuar një nga pretendimet e tij për këtë operator ekonomik dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori do të ndryshojë, duke u skualifikuar nga procedura e prokurimit në fjalë, e për rrjedhojë duke përmbushur kështu interesin e ankimuesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Kevin Konstruktion” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Fled” sh.p.k. me arsyetimin se: *“Operatori ekonomik “FLED” Sh-pk nuk ka paraqitur dokumentacionin e nevojshem ligjor te kerkuar ne dokumentat standarte te tenderit pika 2.3 per mjetet Eskavator me Goma 2(dy) cope dhe Fadrome 1(nje) cope. Ne lidhje me keto mjete operatori ekonomik “FLED” Shpk nuk ka paraqitur leje qarkullimi, siguracion, kolaudim, etj megjithese te treja mjetet jane levizese ne rruge dhe si te tilla kerkohet detyrimisht te jene te pajisura me leje qarkullimi”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 12 *“Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”*, paragrafi i fundit i pikës 2.3, *“Kapacitetit teknik”*, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

“Deshmi per mjetet e pajisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund te vihen ne dispozicion ,qe nevojiten per ekzekutimin e kontrates :

Nr.	Lloji i Makinerive	Sasia
1	Kamion me vinç	1 cope
2	Kamiona mbi 12 ton	1 cope
3	Kamjocine	2 cope
4	Mjete transporti veteshkarkues min.12 ton	1 cope
5	Eskavator me goma	2 cope
6	Fadrome	1 cope
7	Minieskavator	2 cope
8	Prerese asfalti	1 cope
19	Matrapik	2 cope
10	Autobot uji	1 cope
11	Rul per ngjeshje asfalti	1 cope
12	Asfaltoshtrues	1 cope
13	Rul ngjeshes dhe vibrues	1 cope
14	Betoniere	1 cope
15	Gjenerator	1 cope
16	Vibrator	1 cope
17	Depozite uji (5000 litra)	1 cope

Operatori ekonomik duhet te paraqese deklaraten mbi disponimin e makinerive sipas shtojces nr 9.

Deklarata sipas shtojces nr 9 eshte objekt verifikimi dhe kontrolli nga AK, deri ne realizimin e plote te kontrates.

- Makineri - pajisjet ne pronesi te shoqerohen me akt pronesie origjinal ose kopje te noterizuar, ne rast te pronesise me qera te shoqerohen me kontratat e noterizuara te qerase.

Per makinerit duhet te paraqiten (Leje qarkullimi, certif e kontrollit teknik, polica e sigurimit te mjeteve)

- Deklaratë nga administratori i shoqërisë që mjetet e propozuara nuk janë të angazhuara në ndonjë kontratë tjetër.
- Grafiku i punimeve

III.3.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Fled” sh.p.k., për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon.

- Deklaratë ”Mbi disponimin e mjeteve dhe makinerive” e operatorit ekonomik ”Fled” sh.p.k.
- Deklaratë që mjetet e propozuara nuk janë të angazhuara në ndonjë kontratë tjetër.
- Deklaratë e operatorit ekonomik ”Fled” sh.p.k. që mjetet e propozuara janë objekt verifikimi dhe kontrolli nga autoriteti kontraktor, deri në realizimin e plotë të kontratës.

- Faturë tatimore nr.700, datë 20.06.2014 me shitës "Ardmir" sh.p.k. dhe blerës "Fled" sh.p.k. për blerjen e mjetit "Fadromë" (shoqëruar me fotografi të mjetit)
- Faturë tatimore nr.21, datë 20.08.2009 me shitës "Ardmir" sh.p.k. dhe blerës "Fled" sh.p.k. për blerjen e mjetit "Eskavator Fiat Hitachi FH 200" (shoqëruar me fotografi të mjetit)
- Faturë tatimore nr.23, datë 28.02.2018 me shitës "S.A.G" sh.p.k. dhe blerës "Fled" sh.p.k. për blerjen e mjetit "Eskavator me goma" (shoqëruar me Deklaratë Doganore; Urdhër Çlirim; Dokument në gjuhë të huaj (pa përkthim, pa noterizuar); Foto)

III.3.3. Në nenin 46, pika 1/b e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se : *"[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]"*

III.3.4. Në nenin 26, pika 8/c të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar parashikohet se *"Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: ç) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën."*

III.3.5. Ndërsa në nenin 26 pika 5 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar parashikohet se *"Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve".*

III.3.6. Në ligjin Nr.8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, nenin 58, pika 1 dhe 1, parashikohet:

"1. Makinat teknologjike janë makina vetëlëvizëse ose që tërhiqen, me rrota ose me zinxhirë. Këto makina janë të destinuara të operojnë mbi rrugë dhe në kantiere dhe mund të jenë të pajisura me mekanizma specialë. Këto mjete mund të lëvizin në rrugë për të kaluar nga një vend pune në tjetrin ose për të zhvendosur sende që lidhen me ciklin e punës së vetë makinës ose të kantierit, sipas kufizimeve dhe mënyrave të përcaktuara nga aktet në zbatim.

2. Sipas qëllimeve të qarkullimit rrugor, makinat teknologjike ndahen në:

- a) makina që përdoren për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e veprave ndërtimore a të infrastrukturës rrugore ose për rivendosjen e trafikut;*
- b) makina që zhbllokojnë rrugën nga bora ose ndihmëse që shpërndajnë rërë a gjëra të këtij lloji;*
- c) motopirunët dhe elektropirunët: mjete të destinuara për lëvizjen e sendeve."*

Ndërsa në nenin 113 pika 2 e këtij ligji parashikohet: *"2. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike duhen regjistruar në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që i lëshojnë lejen e qarkullimit atij që vërteton se është pronari i mjetit."*

III.3.7. Në VKM Nr.153 datë 07.04.2000 *“Për Miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar, në nenin 282 *“Regjistrimi dhe vendosja e targës e makinave (Neni 113 i Kodit Rrugor)”*, pika 1, parashikohet:

“1.Makinat, te cilat lejohen të qarkullojnë ne rruge sipas nenit 113 të Kodit Rrugor, duhet të regjistrohen prane deges se DRShTRr-se rrethit përkatës, që merret me nxjerrjen e lejes se qarkullimit dhe të targës të atij që deklarohet pronar i mjetit.”

III.3.8. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.3.9. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht dhe ka përcaktuar në mënyrë taksative që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën mësipërme të prokurimit duhet të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm për mjetet në pronësi me anë të të cilit të vërtetojnë se disponojnë makineritë e kërkuara ku përfshihen edhe mjetet dy 2 (dy) eskavator me goma dhe 1 fadromë.

Sqarojmë se, autoriteti kontraktor në mënyrë detyruese ka kërkuar dhe ka përcaktuar në kriteret e veçanta të kualifikimit, që mjetet e paraqitura nga operatorët ekonomikë të jenë të shoqëruara me dokumentacionin e duhur e të nevojshëm e konkretisht me lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik si dhe policën e sigurimit të mjetit. Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimes për skualifikimin e operatorit ekonomik “Fled” sh.p.k, me arsyetimin se ky i fundit nuk ka paraqitur lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik dhe policën e sigurimit për mjetet eskavator dhe fadromë të kërkuara nga autoriteti kontraktor, KPP nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Fled” sh.p.k., konstaton se ky i fundit përveç dokumentacionit të cituar më sipër, nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, dokumentacion ky i detyrueshëm për t'u paraqitur.

Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm të paraqitur nga operatori ekonomik “Fled” sh.p.k., në përmbushje të kriterit për mjetet eskavatorë dhe fadromë, sqarojmë se, referuar legjislacionit të fushës përkatëse, si më sipër cituar, konkretisht Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë dhe VKM Nr.153 datë 07.04.2000 *“Për Miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”*, parashikohet se mjetet e mësipërme duhet të regjistrohen në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor të rrethit përkatës, të cilët lëshojnë lejen e qarkullimit për pronarin e mjetit.

Si rrjedhim në kushtet kur nga ana e ligjvënësit është parashikuar pajisja e mjeteve me leje qarkullimi, si dhe nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri që duhet të paraqitet dokumentacioni i domosdoshëm për mjetet (leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik dhe policë siguri) ku përfshihen edhe mjetet eskavator dhe fadromë, konstatojmë se operatori ekonomik “Fled” sh.p.k. nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor për këto mjete, duke mos e përmbushur kështu kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Pra sa

më sipër, nga verifikimet e kryera konstatohet se operatori ekonomik “Fled” sh.p.k. nuk plotëson kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor për mjetet eskavator dhe fadromë sipas kërkesave në dokumentat e tenderit.

Në rastin konkret, dokumentacioni i paraqitur nga ana e operatorit ekonomik “Fled” sh.p.k. në këtë procedurë prokurimi, objekt shqyrtimi, nuk është i rregullt, pasi ka mungesë fizike të dokumentacionit, kërkesa këto të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

III.3.10. Kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

Sqarojmë se, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë.

III.3.11. Akoma më tej, në rast se operatori ekonomik do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e mësipërme të autoritetit kontraktor përsa i përket dokumentave të tenderit, specifikimeve teknike etj., publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar parashikohet se: “*Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni*”.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesave të mësipërme, ai gjithashtu ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së.

Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.*

Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

III.3.12. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Fled” sh.p.k. në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk konsiderohet i vlefshëm.

Nuk mund të lejohet kualifikimi i një operatori ekonomik në rast se ai ka mungesë dokumentacioni dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga vetë autoriteti kontraktor.

Në rastin konkret, dokumentacioni i paraqitur nga ana e operatorit ekonomik “Fled” sh.p.k. në këtë procedurë prokurimi, objekt shqyrtimi, nuk është i rregullt dhe për shkak të mangësive që ka nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i pavlefshëm.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Në lidhje me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” sh.p.k. për kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “Fled” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që i është pranuar një nga pretendimet e tij për këtë operator ekonomik dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori do të ndryshojë, duke u skualifikuar nga procedura e prokurimit në fjalë, e për rrjedhojë duke përmbushur kështu interesin e ankimuesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Kevin Konstruktion” sh.p.k. për shtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorët ekonomikë “Spektri” sh.p.k. dhe “Sireta 2F” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, fati i këtyre shoqërive është përcaktuar tashmë prej vendimit të KVO-së të datës 28.03.2019, ku këto shoqëri rezultojnë të skualifikuara nga kjo procedurë prokurimi, e për rrjedhojë pa asnjë ndikim në interesat e ankimuesit. Për më tepër, nga verifikimi i informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, si dhe nga shqyrtimi administrativ në KPP, nuk rezulton që këto operatorë ekonomikë të jetë ankimuar në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Rrjedhimisht, pretendimet e operatorit ekonomik “Kevin Konstruktion” sh.p.k. për shtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorët ekonomikë “Spektri” sh.p.k. dhe “Sireta 2F” sh.p.k. nuk do të merren në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-05915-01-31-2019, me objekt “*Rikonstruktion i Rrugëve dhe Qendrës në fshatin Bilçë, Njësia Velabisht, Bashkia Berat*”, me fond limit 12.447.248 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 11.03.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Berat.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Sark” sh.p.k., dhe “Fled” sh.p.k., dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke i skualifikuar këta operatorë ekonomikë nga procedura e prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 686 Protokolli

Datë 12.04.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Enkeleda Bega	Vilma Zhupaj	Lindita Skeja	Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha